



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr.4 Regj.Them.**

**Datë Rregj. 16.03.2023**

**Nr.4 VENDIMI**

**Datë 21.03.2023**

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

**Gjyqtare:** Alma KOLGJOKA (*Relatore*)  
**Gjyqtare:** Edlira PETRI (*Anëtare*)  
**Gjyqtare:** Manjola XHAXHO (*Anëtare*)  
**Gjyqtar:** Sokol IBI (*Anëtar*)  
**Gjyqtare:** Marsela DERVISHI (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore *Ermelinda Nuraj*, sot më datë 21.03.2022, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.4 Akti datë 16.03.2023 që i përket:

**PADITËS:** Partia “Lëvizja BASHKË”, përfaqësuar nga z. Arlind Qori, Kryetar i përkohshëm i Partisë ‘Lëvizja BASHKË’, me seli në Tiranë, Rr. “Abdulla Keta”, nr. 1, mbrojtur me deklaram në seancë gjyqësore nga Av.Gentian Serjani, nr.9664 liçence e NIPT M02516206K.

**IPADITUR:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Erdal Mema, pajisur me Autorizimin nr.1757 Prot. datë 20.03.2023.

**OBJEKTI:** Gjykimin e çështjes në themel duke:  
-rrëzuar vendimin nr.157 datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;  
-rrëzuar vendimin nr.23 datë 14.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, dhe;  
-detyruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrimin e Partisë Politike “Lëvizja BASHKË” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve për qeverisjen vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 64, 145 e vijues të Kodit Zgjedhor; nenet 9, 13 dhe 15 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoji pretendimet e fundit të palëve, ku:

**Pala paditëse, Partia ‘Lëvizja BASHKË’** kërkoi:

- Detyrimin e KQZ për regjistrimin e partisë politike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.

**Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** kërkoi:

- Rrëzimin e padisë.

### **VËREN:**

1. Se pala paditëse, Partia “Lëvizja BASHKË” i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt “Gjykimin e çështjes në themel duke: rrëzuar vendimin nr. 157, datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; rrëzuar vendimin nr. 23, datë 14.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, dhe detyruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrimin e Partisë

Politike “Lëvizja BASHKË” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve për qeverisjen vendore të datës 14 maj 2023”,

## **I. FAKTET E CËSHTJES:**

2. Pala paditëse/subjekti Partia “Lëvizja BASHKË” është parti politike regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2 datë 02.03.2023, marrë formë të prerë më datë 20.03.2023, me Drejtues të përkohshëm të Bordit, i mandatuar z.Arlind Qori, me të cilin është vendosur:

*“Pranimin e kërkesës.*

*-Regjistrimin si person juridik të Partisë “Lëvizja BASHKË”, në Regjistrin e Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.*

*Partia “Lëvizja BASHKË” është një organizatë politike e pavarur, e ndërtuar si bashkim vullnetar të shtetasve shqiptar mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve dhe interesave të perbashkëta politike, me qëllim që të ndikoj në jetën politike të vendit, për demokratizimin dhe zhvillimin e tij, nëpërmjet përfaqësuesve të saj në organet e zgjedhura të pushtetit. Partia mbështetet në parimet e demokracisë liberale, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.*

*Qëllimi dhe objektivat kryesore të kësaj partie janë të përcaktuara në Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.*

*Statuti rregullon organizimin e përgjithshëm të Partisë ‘Lëvizja BASHKË’ duke përcaktuar organet e Partisë të cilat janë: - Organet e ‘Lëvizjes BASHKË’ jane:*

*-Kongresi;*

*-Këshilli Koordinues;*

*-Sekretariati*

*-Baza*

*-Koordinatori;*

*-Komisioni i Etikës dhe Statutit;*

*-Kryetari;*

*-Sekretari Organizativ;*

*-Përgjegjësi*

*Financave.*

*-Grupi nismëtar/anëtarët themelues në cilësinë e Bordit të përkohshëm të grupit Nismëtar, në bazë të Ligjit Nr. 8580 dt. 17. 02. 2000 “Për partitë politike”, i*

*ndryshuar, përfaqësojnë këtë organizatë politike deri në zgjedhjen e organeve vendimmarrëse të saj sipas statutit. Drejtues i përkohshëm i këtij Bordi është mandatuar z. Arlind Qori Kreu i Grupit Nismëtar ushtron funksionet e Kryetarit të Përkohshëm për periudhën deri në konstituimin e organeve të Partisë.*

*-Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeh ligji për partitë politike si dhe nga çdo burim tjetër jo publik që autorizon ai.*

*-Emri i plotë i partisë është Partia “Lëvizja BASHKË” dhe inicialet e saj janë BASHKË.*

*-Selia e Partisë është në adresën: “Rr. Abdulla Keta”, Nr. 1, Tiranë.*

*-Partia “Levizja BASHKE” ka vulën e saj, e cila është në formë drejtkëndore, e kornizuar në ngjyrë të kuqe, brenda së cilës do të vendoset Stema e Partisë, e gjitha në ngjyrë të kuqe.*

*-Numri i anëtarëve të saj është 3835 shtetas shqiptarë.*

*-Shpërbërja e Partisë bëhet sipas legjislacionit në fuqi.*

*-Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të bëjë regjistrimin e Partisë “Lëvizja BASHKË” .*

*Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.*

*Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij”..*

2.1 Pala e paditur/Komisioni Qendror i Zgjedhjeve/palë e paditur, është institucioni shtetëror i ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e vendosura në Kodin Zgjedhor.

3. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.13864 datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Për të qenë pjesë e këtyre zgjedhjeve, Partia “Lëvizja Bashkë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Arlind Qori, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues: a) Shkurtim vendimi me nr. 2, datë 2.3.2023, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02); c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.157 datë 09.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Lëvizja BASHKË” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin ka vendosur,

1. Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor partinë politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “BASHKË”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

#### 4.1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndër të tjera ka arsyetuar:

Partia “Lëvizja Bashkë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Arlind Qori, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

a) Shkurtim vendimi me nr. 2, datë 2.3.2023, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;

b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);

c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

a) Emri zyrtar i partisë është “Lëvizja Bashkë” me shkronja nistore “BASHKË”, me adresë Rruga “Abdulla Keta, nr. 1, Tiranë;

b) Kryetari i partisë është z. Arlind Qori, me adresë, Rruga “Pjetër Budi”, Pall. 62, Shk. 3. Ap. 36, Tiranë;

c) Financieri i partisë është z. Xhuliano Bregasi, me adresë, Rruga “Abdulla Keta”, nr. 1, Tiranë;

ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Viktor Çipi, me adresë, Rruga “Abdulla Keta”, Godina. 9, Shkalla. 4, Ap. 7, Tiranë;

d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

*Kërkesa e paraqitur nga partia “Lëvizja Bashkë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.*

*Neni 64,pika 2,shkronja “a“, e Kodit Zgjedhor, parashikon se partia politike për tu regjistruar si subjekt zgjedhor duhet të paraqesi një vërtetim që vërteton se partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

*Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike rregullohet sipas ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000“Për partitë politike”, i ndryshuar.*

*Sipas nenit 9 të këtij ligji “Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, numri i anëtarëve themelues shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent”.*

*Nga përmbajtja e kësaj dispozite, krahas të tjerave del qartë që:*

*(i) është gjykata e shkallës së parë Tiranë kompetente për regjistrimin e partive;*

*(ii) ka një regjistër të partive politike ku shënohen të dhënat e partisë.*

*Kjo do të thotë që të tretët marrin dijeni mbi personalitetin juridik të partisë politike nga ky regjistër.*

*Kjo vlen edhe për KQZ-në, për rastin kur kërkohet që ky institucion të shqyrtojë kërkesën e paraqitur nga një parti për t`u regjistruar si subjekt zgjedhor.*

*Partia “Lëvizja Bashkë” ka depozituar në KQZ Shkurtim Vendimi me nr.2 datë 2.3.2023, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin vërtëton regjistrimin e saj në Gjykatë. Në përmbajtje të dispozitivit gjykata shprehet se ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij. Nga përmbajtja e dispozitivit del qartë se ky vendim nuk është i formës së prerë e si rrjedhojë nuk është i pasqyruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*

*Në analizë të sa më sipërcituar del qartë se Partia “Lëvizja Bashkë” nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për t`u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 Maj 2023.*

5. Kundër këtij vendimi pala paditëse/subjekti Partia “Lëvizja BASHKË”, ka paraqitur ankesë më datë 11.03.2023 në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt: “Kundërshtim i vendimit nr. 157, datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike ‘Lëvizja BASHKë’ me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore ‘Bashkë’, në zgjedhjet për organet vendore të datës 14 maj 2023”.

6. Kërkesa ankimore i`u paraqit Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z.Elvis Çefa<sup>2</sup>. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 14.03.2023, ora 09:00. Me vendimin nr.23 datë 14.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.30 datë 11.03.2023 të subjektit “Lëvizja BASHKË”, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ka vendosur:

- 1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.30 datë 11.03.2023 të paraqitur nga subjekti “Lëvizja Bashkë”;*
- 2. Lënien në fuqi të vendimit nr.157 datë 09.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrim Lëvizja Bashkë”;*
- 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;*
- 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.*

#### 6.1. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar:

- 1. Partitë politike janë një formë organizimi social, ku një grup personash me pikëpamje, bindje dhe interesa politike të përbashkëta, të cilët kanë për qëllim ndikimin në jetën e vendit, mbliidhen dhe organizohen, për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të përfaqësuar popullin në organet e zgjedhura të pushtetit.*
- 2. Mënyra e krijimit dhe organizimit të partive politike në Republikën e Shqipërisë rregullohet në ligjin nr. 8580, datë 17.02.200 "Për Partitë Politike". Neni 9 i ligjit për partitë politike parashikon se regjistrimi i partive politike bëhet ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila mban regjistrin e partive politike. Partia politike*

---

<sup>2</sup> Me vendimin nr. 21, datë 13.03.2023 “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 30 të subjektit “Lëvizja BASHKË”, për shkak kërkesa ankimore i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të neneve 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS ka vendosur: 1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 30, datë 11.03.2023, të paraqitur nga Partia “Lëvizja Bashkë”; 2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 14.03.2023, ora 9:00; 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

*njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.*

*Pra, ligji kërkon plotësimin e dy kushteve kumulative në mënyrë që partia politike të fitojë personalitet juridik. Këto dy kushte plotësohen në momente të ndryshme.*

*– Kushti i parë ka të bëjë me miratimin e partisë politike dhe konsiderohet i plotësuar në ditën që gjykata del me vendim për krijimin e partisë politike, vendim të cilin duhet ta marrë brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës.*

*– Kushti i dytë ka të bëjë me regjistrimin e partisë, që ndodh 15 ditë nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës, që është dita kur ky vendim merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm. Në këtë moment, ky vendim pasqyrohet në regjistrin e partive politike.*

*3. Vetëm pas plotësimit të të dy kushteve të mësipërme, konsiderohet se partia politike gëzon personalitet juridik për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.*

*Deri në plotësimin e të dyja kushteve kumulativisht, partia nuk ka tagër për të kryer veprime juridike, përveç veprimeve të nevojshme për organizimin e saj, siç janë mbledhja e themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese të partisë; sipas parashikimit të paragrafit të tretë në nenin 9 të ligjit “Për partitë politikë”.*

*Për shkak se i mungon personaliteti juridik, “Lëvizja Bashkë” ende nuk mund të veprojë juridikisht me kërkesa që obligojnë palët e treta. Depozitimi i kërkesës për regjistrim në zgjedhje mund të bëhet vetëm pasi partia të ketë fituar zotësinë për të vepruar. Partia politike nuk krijohet për të marrë pjesë në një palë zgjedhje. Ajo krijohet për të ndikuar në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve në dekada. Për këtë arsye nuk justifikohet dot ligjërisht zgjidhja emergjente, jashtë kushteve dhe kriterëve ligjore, që kërkon ankuesi.*

*4. Përfaqësuesi i subjektit ankues ngriti pretendimin në seance se: "ekziston një precedent i ndjekur nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve në vitin 2019 për regjistrimin e partisë 'Bindja Demokratike' si subjekt zgjedhor”.*

*Një tjetër rast i ngjashëm, por me tjetër vendimmarrje, i shqyrtuar nga KQZ, është vendimi nr.158/2015 për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Shkodra 2015” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, ku KQZ vendosi mosregjistrimin e kësaj partie për shkak se vendimi i regjistrimit të partisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk kishte marrë formë të prerë në momentin e paraqitjes së kërkesës në KQZ.*



*KAS arsyeton se sistemi ligjor shqiptar sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nuk është sistem që bazohet mbi precedentin, por sistem që bazohet në ligjin e shkruar. Kësisoj, vendimet e marra më parë nga KQZ nuk janë të detyrueshme për vendimmarrjen e KAS.*

*Për më tepër, edhe doktrina juridike për precedentin gjyqësor/administrativ nuk e pranon arsyetimin e ankuesit rreth precedentit. Precedenti sipas kësaj doktrine bëhet i tillë vetëm kur jurisprudenca krijon traditë në zgjidhjen e njëllojtë të konflikteve të ngjashme në një periudhe kohore të konsiderueshme. Dy zgjidhje të kundërta për dy çështje të ngjashme të dhëna nga i njëjti organ nuk formojnë dot precedent.*

*5. Për gjithë sa më sipër, në momentin e shqyrtimit të kërkesës në KAS, subjekti ankues “Lëvizja Bashkë” nuk rezulton i regjistruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi nuk është plotësuar ende afati 15 ditor nga data 02.03.2023 që është dita e shpalljes së vendimit të gjykatës. Për këto arsye, ky subjekt nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023.*

*KQZ nuk mund të analizojë dhe gjykojë rreth praktikës së gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm lidhur me zbatimin e afateve procedurale. KAS-i sidomos nuk mund të mbështesë vendimmarrjen e tij tek argumenti se “vonesa” në përmbylljen e procedurave të regjistrimit nuk ka ardhur për faj të ankuesit dhe prandaj ai nuk mund të ndëshkohet për këtë shkak. Mosregjistrimi në zgjedhje është një fakt juridik i veçantë, i cili nuk ka shkak “vonesën” në regjistrim, por ka shkak mungesën e personalitetit juridik dhe të zotësisë për veprim, të cilat janë kushte që nuk mund të anashkalohen.*

7. Partia’ Lëvizja BASHKË’, pasi është bërë me dije me vendimin e K.A.S. duke pretenduar se ky vendim është i pabazuar në ligj dhe në prova i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi.

8. Pala paditëse, Partia ‘Lëvizja BASHKË’ në kërkesëpadi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, pretendoi se:

Bazuar në nenin 13<sup>3</sup> të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar rezulton e provuar se kërkesa për regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë” është depozituar më datë 09.01.2023 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Kjo kërkesë është shqyrtuar tej afateve ligjore një mujore që parashikon ligji “Për partitë politike” (pavarësisht kërkesave të subjektit) dhe konkretisht më datë 02.03.2023.

- Pavarësisht kësaj referuar nenit 64 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, është dorëzuar dokumentacionin në përmbushje të përcaktimeve ligjore për regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet me vendimin nr.157 datë 09.03.2023 vendosi “Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor partinë politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “BASHKË”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Sipas Komisionerit, Partia “Lëvizja Bashkë” nuk e përmbushte detyrimin ligjor për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 majit 2023, pasi vendimi nr.2 datë 02.03.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është i formës së prerë e si rrjedhojë nuk është i pasqyruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo vendimarrje e Komisionerit u la në fuqi nga Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, duke i qëndruar argumentit të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhje.
- Neni 9 i ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar përcakton se partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Në vendimin nr.2 datë 02.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është miratuar njohja e partisë politike “Lëvizja BASHKË” si person juridik dhe në interpretimin e saj duhet të konsiderohet e regjistruar. Afati 15 ditor i ankimimit shërben vetëm për të hedhur të dhënat e partisë në regjistrin e partive.
- Pala paditëse parashitroi se arsyetimi i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve se miratimi dhe regjistrimi janë dy kushte kumulative dhe partia gëzon personalitet juridik vetëm pasi i plotëson të dyja kushtet nuk është i vlefshëm. Gjithsesi, edhe sikur ky interpretim i KAS të ishte i duhuri,

---

<sup>3</sup> Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji

kushti i dytë i kërkuar nga ana ligjore nuk është i varur në vullnetin e subjektit pasi, nëpërmjet shkresave drejtuar gjykatësit, kancelarit, zv.kryetarit të gjykatës dhe për dijeni Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është treguar se përfaqësuesit e këtij subjekti kanë qenë aktivë në kërkimin e respektimit të afatit ligjor 30 ditor të shqyrtimit të kërkesës nga ana e Gjykatës dhe ka qenë kjo e fundit që nuk e ka respektuar.

- Sipas palës paditëse përvec sa më sipër në regjistrin e partive politike, pavarësisht afatit 15 ditë pas shpalljes së vendimit për t'u regjistruar në regjistër vendimi gjyqësor, si datë e regjistrimit të mirëfilltë konsiderohet data e shpalljes së saj, në rastin e partisë "Lëvizja BASHKË" data 2 mars 2023, (neni 9 i ligjit për partitë politike), datë kjo më e hershme se data 6 mars kur ishte afati për regjistrimin e partive politike në KQZ për zgjedhjet vendore të 14 majit. Në këtë kuptim, marrja në dorëzim e vendimit të formës së prerë në datën 18 mars (ose të hënën më 20 mars në rast se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë refuzon të japë vërtetime dhe të kryejë regjistrime gjatë ditëve të pushimit zyrtar në fundjavë) do të mund të interpretohej si konfirmim i faktit se Lëvizja BASHKË është regjistruar paraprakisht që në datën e shpalljes së saj nga gjykatësi në datën 2 mars 2023. Kësisoj nuk do të binte ndesh me afatin 70-ditor përpara ditës së zgjedhjeve që Kodi Zgjedhor vendos për regjistrimin në KQZ të partive politike.
- Sipas palës padiëse ashtu sic ka argumentuar pakica në vendimin e KAS, ajo e ka respektuar ligjin e partive politike dhe ka depozituar dokumentacionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 9 janar 2023, që do të thotë se nëse gjykata do të respektonte afatin maksimal prej 30 ditësh, Lëvizja BASHKË do të ishte njohur si parti që më datën 9 shkurt 2023 dhe do të ishte futur në regjistrin e partive politike që në datën 24 shkurt 2023, atëherë kur vendimi do të ishte i formës së prerë. Pra, 11 ditë përpara mbarimit të afatit 70 ditor përpara mbajtjes së zgjedhjeve që vendos Kodi Zgjedhor për regjistrimin e partive në KQZ. Cenimi i kësaj të drejte në fillim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas nga KQZ shkel parimet e pluralizmit politik dhe barazisë së subjekteve politike përpara ligjit, siç përmendet në vendimin nr. 32 të datës 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese.
- Sipas palës padiëse edhe sikur dokumentacioni i paraqitur nga Lëvizja BASHKË në datën 6 mars të konsiderohej i paplotë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të shtynte vendim-marrjen deri pas datës 18 mars, kur

pritet që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të vendosë Lëvizjen BASHKË në regjistrin e partive, ose të nxirrte një akt dobiprurës të regjistrimit të Lëvizjes BASHKË si subjekt zgjedhor me dy kushte: marrjen e vendimit të formës së prerë dhe depozitimin e tij në KQZ përpara datës së regjistrimit të kandidatëve (50 ditë përpara zgjedhjeve të 14 majit).

Sipas palës padiëse ashtu si ka argumentuar pakica me parë KQZ, ka pasur precedent për regjistrimin e Partisë 'Bindja Demokratike' si subjekt zgjedhor më 2019, ndonëse në mungesë të vendimit të formës së prerë. Kësisoj KQZ, duke mos regjistruar Lëvizjen BASHKË, do të përftonte një standard të dyfishtë dhe cenim të barazisë përpara ligjit, si dhe do të përbënte një shkelje të së drejtës së qytetarëve për të zgjedhur partinë që duan.

- Sipas palës paditëse vendim-marrjet e Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe KAS nuk marrin parasysh parimin se pluralizmi është një nga bazat e shtetit demokratik dhe partitë politike janë pikërisht themeli i pluralizmit. Sipas palës padiëse pengimi i saj në kandidimin në këto zgjedhje, pavarësisht se pala paditëse/subjekti nuk ka asnjë përgjegjësi për vonesat e paligjshme që u ka vënë përpara Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, do të ishte goditje e rëndë për të drejtën kushtetuese të organizimit politik të qytetarëve.

**Në seancë gjyqësore** përfaqësuesit e palës paditëse relatuan faktin se tashmë vendimi nr.2 datë 02.03.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte marr formë të prerë më datë 20.03.2023 (konfirmuar me vulën e marrjes formë të prerë të vendimit që mban datën 20.03.2023), duke u përmbushur edhe kushti i dytë kumulativ, regjistrimi i partisë politike, kusht konstatuar i mangët nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet; dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Përsa më sipër, pala paditëse në seancë gjyqësore përfundimisht kërkoi “Detyrimin e KQZ për regjistrimin e partisë politike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023”.

**9. Pala e paditur,** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit prapësoi se:

- Pala e paditur prapësoi se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të

analizojë dhe gjykojë rreth praktikës së Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm lidhur me zbatimin e afateve procedurale. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve nuk mund të mbështesë vendimarrjen e tij tek argumenti se “vonesa në për mbylljen e procedurave të regjistrimit nuk ka ardhur për faj të ankuesit dhe prandaj ai nuk mund të ndëshkohet për këtë shkak”. Mosregjistrimi në zgjedhje është një fakt juridik i veçantë, i cili nuk ka shkak "vonesën" në regjistrim, por ka shkak mungesën e personalitetit juridik dhe të zotësisë për veprim, të cilat janë kushte që nuk mund të anashkalohen.

- Lidhur me pretendimin se kur konsiderohet e regjistruar një parti politike, pala e paditur prapëson se në referim të përmbajtjes së nenit 9 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar vetë ligji kërkon plotësimin e dy kushteve kumulative në mënyrë që partia politike të fitojë personalitet juridik. Këto dy kushte plotësohen në momente të ndryshme:  
*Kushti i parë* ka të bëjë me miratimin e partisë politike dhe konsiderohet i plotësuar në ditën që gjykata del me vendim për krijimin e partisë politike, vendim të cilin duhet ta marrë brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës.  
*Kushti i dytë* ka të bëjë me regjistrimin e partisë, që ndodh 15 ditë nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës, që është dita kur ky vendim merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm. Në këtë moment, ky vendim pasqyrohet në regjistrin e partive politike.

Vetëm pas plotësimit të të dy kushteve të mësipërme, konsiderohet se partia politike gëzon personalitet juridik për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

Për shkak se i mungon personaliteti juridik, "Lëvizja BASHKË" ende nuk mund të veprojë juridikisht me kërkesa që obligojnë palët e treta. Depozitimi i kërkesës për regjistrim në zgjedhje mund të bëhet vetëm pasi partia të ketë fituar zotësinë për të vepruar. Partia politike nuk krijohet për të marrë pjesë në një palë zgjedhje. Ajo krijohet për të ndikuar në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve në dekada. Për këtë arsye, nuk justifikohet dot ligjërishit zgjidhja emergjente, jashtë kushteve dhe kritereve ligjore që kërkon ankuesi. Për sa më sipër, në momentin e shqyrtimit të kërkesës në KAS, subjekti ankues "Lëvizja BASHKË" nuk rezultoi i regjistruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, pasi nuk ishte plotësuar ende afati 15 ditor nga data 02.03.2023, që është dita e shpalljes së vendimit

të gjykatës. Për këto arsye, ky subjekt nuk përmbushi detyrimin ligjor për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023. Përsa më sipër, përfaqësuesi i palës së paditur përfundimisht kërkoi: “Rrëzimin e padisë”.

10. Gjykata pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjoi pretendimet e palëve, çmon se padia me paditës Partia ‘Lëvizja BASHKË’ është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe duhet të pranohet.

11. Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se “*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë*”.

Neni 9 i Kushtetutës parashikon se “*Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike*”.

Neni 45 pika 1 i Kushtetutës parashikon se “*Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet*”.

Ndërsa neni 46 i Kushtetutës, në pikat pika 1 dhe 2 të tij parashikon se “*1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. 2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.*”

11.1 Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, ka theksuar se “*..Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë... (vendimin nr. 32, datë 21.06.2010).*

11.2 Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”<sup>4</sup> në nenin 64 të tij parashikon se:

*Regjistrimi i partive politike si subjekte zgjedhore*

1. Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

2. Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ: vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë; emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët; emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë;

ç) specimenin e vulës së partisë; emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; dhe

dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në.

11.3 Në ligjin nr.8580 datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”<sup>5</sup> në nenin 13 është përcaktuar se “Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji. Në rastin kur dokumentet e partive politike nuk janë të rregullta, gjykata, brenda 20 ditëve e kthen kërkesën për të bërë plotësimet përkatëse”. Kurse në nenin 15 të po këtij ligji përcaktohet se: Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës

12. Kolegji Zgjedhor vëren se në kuptim të parashikimeve të përmbajtura në ligjin nr.8580 datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike” pala paditëse/partia “Lëvizja Bashkë” i ka marrë të gjithë masat e duhura për regjistrimin brenda afateve të përcaktuara në ligj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kështu ka rezultuar se anëtarët themelues të partisë politike “Lëvizja Bashkë”, e kanë dorëzuar kërkesën në gjykatë në datën 09.01.2023, kërkesë e cila është regjistruar në datën 12.01.2023 dhe sipas nenit 13 pika 1 të ligjit të sipërcituar, gjykata duhet të ishte

<sup>4</sup> Ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, nr. 31/2015, datë 02.04.2015, nr. 101/2020, datë 23.7.2020, nr. 118/2020, datë 5.10.2020; shfuqizuar një pikë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 30.6.2021, shfuqizuar një fjali me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 4.10.2021

<sup>5</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 9452, datë 2.2.2006

shprehur me vendim përfundimtar jo më vonë se data 11.02.2023. Është i provuar gjithashtu fakti se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtimin e kësaj kërkesë në datën 02.03.2023 dhe e ka pranuar atë me vendimin nr.2 datë 02.03.2023, pra dukshëm në tejkalim të afatit 30 ditor të parashikuar në ligjin e posaçëm për partitë politike.

12.1. Gjithashtu rezulton se subjekti paditës/partia ‘Lëvizja BASHKË’ më datë 06.03.2023 ka depozituar pranë KQZ kërkesën për regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor brenda afateve të parashikuara në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, bashkë me dokumentacionin shoqërues, por që për shkak të mospërmbushjes së afatit 15 ditor nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës për regjistrimin e saj, vendimi nuk kishte marrë formë të prerë si në datën e shqyrtimit të kërkesës për regjistrim si subjekt zgjedhor pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ashtu edhe në datën e shqyrtimit të kërkesës ankimore pranë KAS. Për rrjedhojë, rezulton se subjektit paditës i mungonte dokumenti i parashikuar nga neni 64 pika 2 shkronja “a” i Kodit Zgjedhor që është “vërtetimi që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

13. Kolegji Zgjedhor mban në vëmendje se qëllimi, që një parti politike të regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, është pjesëmarrja në zgjedhje me kandidatë për kryetarë të njësive të qeverisjes vendore dhe lista të kandidatëve për këshillat vendore.

13.1 Ndërkohë në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit më datë 20.03.2023 ora 14:30 është depozituar vendimi nr.2 datë 02.03.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (i zbardhur), i cili ka marrë formë të prerë më datë 20.03.2023; si dhe Vërtetimi datë 20.03.2023, i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku citohet se: *“Vërtetohet se në Regjistrin e Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se me vendimin nr.2 datë 02.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është miratuar regjistrimi i Partisë “Lëvizja BASHKË”, dhe inicialet e saj janë BASHKË. Kryetar i përkohshëm i partisë është z. Arlind Qorri”* të cilat u morën në cilësinë e provës.

13.2. Në nenin 9 të ligjit nr.8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i



ndryshuar, ligji kërkon plotësimin e dy kushteve kumulative në mënyrë që partia politike të fitojë personalitet juridik. Këto dy kushte plotësohen në momente të ndryshme:

*1-Kushti i parë* ka të bëjë me miratimin e partisë politike dhe konsiderohet i plotësuar në ditën që gjykata del me vendim për krijimin e partisë politike, vendim të cilin duhet ta marrë brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës.

*2-Kushti i dytë* ka të bëjë me regjistrimin e partisë, që ndodh 15 ditë nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës, që është dita kur ky vendim merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm. Në këtë moment, ky vendim pasqyrohet në regjistrin e partive politike.

Vetëm pas plotësimit të të dy kushteve të mësipërme, konsiderohet se partia politike gëzon personalitet juridik për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

13.3. Në çështjen objekt gjykimi, konstatohet se në ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore (data 21.03.2023), janë plotësuar të dy kushtet e mësipërme kumulative, pra partia “Lëvizja BASHKË” është miratuar me vendimin nr.2 datë 02.03.2023 dhe është regjistruar në regjistrin e partive politike më datë 20.03.2023.

13.4 Kolegji Zgjedhor vuri në diskutim ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së për refuzimin e regjistrimit, referuar faktit se në kohën e paraqitjes së kërkesës për regjistrim të subjektit zgjedhor, si dhe në ditën e marrjes së vendimit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendimi gjyqësor për regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë” nuk kish marrë ende formë të prerë. Nisur nga parimi i pluralizimit dhe duke mbajtur në vëmendje edhe rregullat që garantojnë një proces zgjedhor të caktuar, Kolegji Zgjedhor, vlerëson se ishin të gjitha mundësitë që kërkesa e partisë “Lëvizja Bashkë”, të shqyrtohej në mënyrë të tillë që të respektoheshin parimet e së drejtës dhe dispozitat e Kodit Zgjedhor. Kështu, Kodi Zgjedhor, ndërsa cakton afate për paraqitjen e kërkesave për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, nuk cakton afat për marrjen e vendimit lidhur me këto kërkesa. Rregullat për regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe listave të kandidimit, përcaktojnë kushtet dhe afatet, që garantojnë rregullshmërinë e vetë procesit zgjedhor. Në këtë kuptim, vendimet që merr KQZ-ja, në lidhje me këto çështje, do të duhet të kenë në konsideratë si garantimin e pluralitetit të subjekteve garues, ashtu edhe vetë procesin që do të duhet të ndjekë fazat përkatëse, brenda

afateve ligjore. Nga përmbajtja e Kodit Zgjedhor, pas regjistrimit të subjekteve zgjedhore, kryhet regjistrimi i koalicioneve dhe më pas paraqiten listat e kandidimit. Kundrejt afateve që përcakton Kodi Zgjedhor, lidhur me këto hapa përgatitore për procesin, nuk caktohet ndonjë afat i prerë për KQZ-në, lidhur me marrjen e vendimit për regjistrimin e subjektit zgjedhor, koalicionit, apo listat e kandidimit. Nga interpretimi i dispozitave përkatëse të Pjesës IV të Kodit Zgjedhor “Regjistrimi i subjekteve”, afati final i përfundimit të kësaj faze të procesit, është ai 40 ditor para ditës së zgjedhjeve. Kjo është data kur përfundon tërësisht si regjistrimi i subjekteve zgjedhore, ashtu edhe listat e tyre të kandidimit. Referuar po këtyre dispozitave dhe posacërisht nenit 67 të Kodit Zgjedhor, afati për depozitimin e listave të kandidatëve është deri 50 ditë para ditës së zgjedhjeve. Në rastin konkret për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, është data 25.03.2023 (kjo ditë është ditë e shtunë, ndaj afati shtyhet për në datë 27 mars 2023). Në këto kushte, kur kërkesa e palës paditëse është depozituar në afatin e përcaktuar në ligj, si dhe kur e vetmja e metë e konstatuar në vendimin e datës 09.03.2023 të KSHZ, lidhej me faktin se vendimi i gjykatës për regjistrimin e kësaj partie politike nuk kish marrë ende formë të prerë, vihet në diskutim, nëse vendimi për refuzimin për regjistrim, ishte zgjidhja e drejtë e kësaj çështje. Kolegji Zgjedhor, vlerëson se mungesa e një afati ligjor të prerë për Komisionerin, brenda të cilit ai duhej të merrte një vendim për kërkesën për regjistrim të subjektit zgjedhor, linte mundësinë e aplikimit të nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative. Bazuar në këtë dispozitë, KSHZ mund të merrte një vendim të ndërmjetëm për pezullimin e procedurës së nisur, deri në përfundim të afatit të ankimit ndaj vendimit gjyqësor për regjistrimin e partisë politike kërkuese (afati i ankimit përfundonte në datë 17.03.2023). Pezullimi i çështjes deri në përfundim të afatit të ankimit, nuk cenonte procesin zgjedhor, të drejtat e kërkuarit dhe as ato të subjekteve të tjera zgjedhore. Përkundrazi, pezullimi i çështjes deri në datë 20.03.2023 (dita e hënë pas përfundimit të afatit të ankimit), do të mundësonte marrjen e një vendimi të drejtë në raport me kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor. Po ashtu, ky vendim i ndërmjetëm, nuk cenonte as fazën tjetër të regjistrimit të listave të kandidatëve, që eventualisht do të paraqiteshin, nëse partia politike do të regjistrohej si subjekt zgjedhor, pasi data 20 mars, i paraprin datës 27 mars, kur ishte afati i fundit për depozitimin e këtyre listave.

13.5. Në këto kushte, Kolegji Zgjedhor çmon se me miratimin dhe regjistrimin në regjistrin e partive politike të partisë “Lëvizja BASHKË” kanë ndryshuar rrethanat në të cilat janë dhënë vendimi nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe KAS. Tashmë janë plotësuar të dy kushtet e mësipërme kumulative, pra partia “Lëvizja BASHKË” është miratuar me vendimin nr.2 datë 02.03.2023 dhe është regjistruar në regjistrin e partive politike më datë 20.03.2023.

14. Për sa më sipër, Kolegji çmon se padia e paraqitur nga Partia ‘Lëvizja BASHKË’ është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe duhet të pranohet. Kolegji thekson se çështja objekt shqyrtimi merr zgjidhje bazuar në argumentet e mësipërme dhe çdo pretendim tjetër i palëve në lidhje me mosmarrëveshjen nuk con në një përfundim tjetër të saj dhe për pasojë nuk analizohet më tej.

### **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,

### **V E N D O S I**

- Pranimin e padisë.
- Detyrimin e palës së paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të regjistrojë partinë politike “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve për qeverisjen vendore të datës 14 maj 2023.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 21.03.2023.

**GJYQTARE**  
**Manjola XHAXHO**

**GJYQTARE**  
**Edlira PETRI**

**GJYQTARE**  
**Alma KOLGJOKA**

**GJYQTAR**  
**Sokol IBI**

**GJYQTARE**  
**Marsela DERVISHI**